



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.449/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, më Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.449/2023 të datës 03.03.2023 të parashtruar nga ankuesi _____, nga Shtimja, kundër organit të punësimit Komunës së Shtimes, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 24.03.2023, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.449/2023 e datës 03.03.2023, e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi, _____, kandidat për shërbimin civil, më datë 02.03.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër refuzimit të aplikacionit për pozitën Specialit i Përgjithshëm për Shërbime Sociale sipas Vendimit Nr.02/1-48 të datës 24.01.2023 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Shtimes.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 09.03.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komuna e Shtimes, ndërsa kjo e fundit më datë 17.03.2023 ka dërguar shkresat lidhur me çështjen në procedurë ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 2253/2023 të datës 03.03.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës

për Shërbimin Civil të Kosovës; Emailin e datës 02.03.2023 nga ankuesi për ankesa.kpmshec@rks-gov.net; Diplomën me Nr.3819 të datës 26.03.2015 të ankuesit; Diplomën me numër protokolli 2296/2002 të datës 20.06.2022 për ankuesin; Certifikatën penale të datës 07.02.20233; Certifikatën e datës 14.09.2010; Pasqyrën e Trsutit për ankuesin për periudhën 17.03.2008-23.02.223; Vërtetimin me numër protokolli 01/1571/31 i datës 27.05.2004; Vërtetimin me Nr.3672/2015 i datës 08.10.2015; Kopje e ID-së së ankuesit; Letër reference për punë për ankuesin nga Capital; Letër motivimi e ankuesit; Ekstrakt nga regjistri qendror i gjendjes civil me Nr. E 26863203; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokolli 2541/2023 të datës 09.03.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 17.03.2023; Konkursin me Nr.Reference RN00010592 për emrin e grupit "Specialit të Përgjithshëm të Shkencave Sociale-Zyrtar për Shërbime Sociale 2"; Listën e aplikantëve të aprovuar dhe refuzuar; Vendimin me numër 02 Nr. 29 të datës 27.01.2023 për emërimin e Komisionit të Pranimit në Shërbimin Civil; Njoftimin për listën përfundimtare të verifikimit paraprak i datës 30.01.2023; Vendimin me Nr. 02/1-48 të datë 24.01.2023 të Njesisë e Burimeve Njerëzore të Komunës së Shtimes; Aplikacionin e ankuesit i datës 09.01.2023; Rezultatet përfundimtare të datës 01.03.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimi dhe analizimit të provave të lëndës, konstatoi së ankesa me numër A.nr.449/2023 e datës 03.03.2023, e parashtruar nga ankuesi [REDACTED], është e palejuar, sepse:

Bazuar në shkresat e administruar rrjedhë së Komuna e Shtimes më datë 14.12.2022 ka publikuar konkursin e hapur me numër reference RN00010592, për emrin e grupit "Specialit të Përgjithshëm të Shkencave Sociale/Zyrtar për Shërbime Sociale 2", klasa profesional 2, dy pozita, dhe së i njëjti ka qenë i hapur për aplikim për periudhën kohore 04.01.2023 deri atë 12.01.2023.

Me tej nga shkresat e kësaj çështje rezulton, së në konkursin më numër reference RN00010592, ka aplikuar edhe anësuesi, mirëpo të njëjtit me Vendimin Nr.02/1-48 të datës 24.01.2023 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Shtimes i është refuzuar aplikacioni i datës 09.01.2023, më arsyetimin së ankuesi nuk ka plotësuar kushtet formale respektivisht përvojën e punës lidhur me pozitën e shpallur.

Pas vendimit lidhur me refuzimin e aplikacionit, ankuesi ka parashtruar ankesë drejtpërdrejt në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet se i është bërë padrejtësi, pasi qe nuk është njoftuar me kohë lidhur më arsyet e refuzimit të aplikacionit dhe së me vonë ka kuptuar që me rastin e aplikimit ka munguar dokumenti i përvojës së punës.

Lidhur me vendosjen e kësaj çështje juridike-administrative, Kolegji i Këshillit mori parasysh dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenin 15 paragrafi 5 dhe 6 të më të cilat është përcaktuar se: "...5. Kandidatë, që nuk plotësojnë kushtet për aplikim në pajtim më paragrafin 1 të këtij neni, nuk kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurrimin. Vendimi për mosplotësimin e kushteve për aplikim, arsyetohet dhe u njoftohet individualisht aplikantëve, jo më vonë se katërmëdhjetë (14) ditë kalendrike nga data përfundimtare e pranimit të aplikacioneve. 6. Brenda tre (3) ditëve nga data e njoftimit individual, në përputhje me paragrafin 5 të këtij neni, kandidatët e njoftuar që nuk plotësojnë kushtet e aplikimit, kanë të drejtë të paraqesin ankesë të brendshme. Ankesa parashtrohet më shkrim pranë Njesisë Përgjegjëse. Ankesa shqyrtohet nga Njësia Përgjegjëse e cila me vendim e njofton kandidatin brenda pesë (5) ditëve nga paraqitja e saj..." si dhe nenin 31 paragrafi 1 dhe 2 të më të cilin parashihet se: 1.Kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil,

i cili është i pakënaqur me vendimin e organit të punësimit, ka të drejtë të parashtojë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil (në vijim në tekstin e kësaj Rregullore "Këshilli") . 2. Ankesa në Këshill parashtrohet vetëm pas shterimit të procedurës të brendshme të ankesës të organit përkatës që ka nxjerrë aktin apo kryer veprimin që kundërshtohet..." dhe si rrjedhojë mbi bazën e këtij përcaktimi ligjor, Kolegji i Këshillit konstaton së kandidati të cilit i është refuzuar aplikacioni për shkak të mos plotësimit të kushteve për pozitën e shpallur, fillimisht duhet të ushtroj ankesë të brendshme të Njësia e Burimeve Njerëzore, e me tej mund të ushtroj ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Andaj, nisur nga ky konstatim dhe meqenëse me asnjë provë të parashtruar nga palët në procedurë nuk vërtetohet së ankuesi ka kundërshtuar ligjshmërinë e vendimit për refuzimin e aplikacionit, përmes ushtrimit të ankesës së brendshme të Njësia e Burimeve Njerëzore, Kolegji i Këshillit gjykon së ankesa e ankuesit A.449/2023 e datës 03.03.2023, e parashtruar drejtpërdrejt në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është e palejueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Theksuar si ma lartë, Kolegji duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nen paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.449/2023

Avdyll BEKTESHI

[Signature]
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Ardita Haxhnikaj-DEMI

[Signature]
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, _____ ;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Shtimes; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

